



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

Në përputhje me autorizimin e dhënë me nenin 17b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 1 tetor 2001 për ndryshimin e Rregullores 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 të datës 5 tetor 2001 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit,

Me qëllim zbatimi të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25,

Këshilli Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2005, miratoi:

Rregullën 4 mbi Ndryshimin e Rregullës për Licencimin e Kompanive të Sigurimit të Përgjithshëm dhe të Sigurimit të Jetës

Neni 1

Marrja e pëlqimit për licencë të kompanisë së sigurimit

1.1 Zbatimi i rregullës

Kjo rregull zbatohet për të gjithë aplikantët që kërkojnë të merren me veprimtarinë e sigurimit të përgjithshëm dhe të sigurimit të jetës në Kosovë.

Njëra ndër kërkesat kryesore për zhvillimin e veprimtarisë së një kompanie të sigurimit është që aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë të jenë “të përgatitur dhe të përshtatshëm” që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre. Në rast se BPK-ja më pas zbulon se ndonjë aspekt i informatave të dhëna në lidhje me kërkesën për licencë të kompanisë së sigurimeve është falsifikuar me qëllim, aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë do t’u nënshtrohen sanksioneve të përshkruara në Rregulloren e sigurimit të Kosovës apo në Rregullat e BPK-së. Kërkesat pezull automatikisht do të refuzohen në këtë rast. Në rastet kur licenca është lëshuar në bazë të informatave të falsifikuara, licenca për kompani të sigurimeve mund të tërhiqet menjëherë.

Aplikantët që janë marrë me ndonjë aktivitet që ka rezultuar me akuza kriminale, të zgjidhura apo pezull, automatikisht do të diskualifikohen nga konsiderata e mëtutjeshme. Ky diskualifikim do të bëhet për kërkesat e tanishme dhe të ardhshme për licencë të kompanisë së sigurimit, dhe atë përderisa gjykata kompetente e Kosovës të mos anulojë përfundimisht akuzat.

1.2 Kërkesat për të gjithë aplikantët

- a. **Informata plotësuese:** BPK-ja ka të drejtë gjatë tërë kohës për të kërkuar informata plotësuese për këto çështje:
- b. **Gjuha:** Të gjitha kërkesat duhet të dorëzohen në shqip dhe /ose serbisht apo anglisht.
- c. **Provizioni për kërkesë/licencë:** Aplikantët-parashtuesit e kërkesës për licencë duhet të paguajnë provizionin për shqyrtim të kërkesës në shumë prej 10000 euro dhe një provizion plotësues prej 1000 euro për çdo kategori të sigurimeve që aplikojnë për ta ushtruar.
- d. **Të gjithë aplikantët duhet të ofrojnë të dhënat në vijim:**
 - d.1 Kërkesën formale për të ushtruar kategoritë e dëshiruara të biznesit të sigurimit në formatin e siguruar nga BPK. Kategoria e sigurimit të përgjithshëm dhe sigurimit jetësor duhet të caktohen nëpërmjet kompanive të ndara të sigurimit.
 - d.2 Organogramin origjinal për kompaninë e propozuar të sigurimit së bashku me statutin e saj apo dokumentacion ekuivalent.
 - d.3 Biografite e plota për aksionarët e kryesor (kur ata mbajnë apo do të mbajnë më shumë se 10% të aksioneve) drejtorët, menaxherët e lartë që janë të propozuar për kompaninë e sigurimit. Biografia duhet të përmbledhë historinë e tyre profesionale dhe përgatitjen akademike. Biografia e menaxherëve të propozuar ne veçanti duhet të kenë përvojë të konsiderueshme në sigurime, trajnim dhe njohuri. Në mënyrë të qartë kjo do të thotë se menaxherët e propozuar duhet të kenë diplomë nga ndonjë biznes i njohur, institucion me reputacion apo nga ndonjë kompani e njohur për sigurime si dhe përvojë të duhur në sigurime. Historiku akademik dhe kualifikimet profesionale duhet të dorëzohen në BPK për shqyrtim. BPK-ja do të bëjë hetimet e veta për letrat kredenciale dhe historinë.
 - d.4 Listën e të gjithë individëve me adresat e tyre dhe përkatësinë kombëtare të cilët janë/do të jenë të regjistruar si aksionarë kryesorë apo pronarë përfundimtarë të kompanisë së sigurimit. Lista duhet të përfshijë aksionet e secilit aksionar kryesor;
 - d.5 Raportet e kompletuara dhe të vërtetuara të gjendjes financiare dhe burimet financiare për aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë që janë të propozuar për kompani të sigurimit. Këto raporte duhet të vërtetohen nga ndonjë bankë e njohur nga BPK-ja apo firmë e revizionit e licencuar. Çdo përjashtim duhet të aprovohet nga BPK-ja.

d.6 Bankrotimi: Personat që janë deklaruar të bankrotuar nga ndonjë gjyq kompetent në Kosovë apo diku tjetër janë të diskualifikuar nga konsideratat e mëtejshme. Në mënyrë të ngjashme, personat që kanë shërbyer si aksionarë, drejtorë apo menaxher në ndërmarrjet afariste të bankrotuara gjithashtu do të diskualifikohen nga konsideratat e mëtejshme.

d.7 Tri referenca profesionale për secilin aksionar kryesor, drejtor dhe menaxher të lartë që janë propozuar për kompani të sigurimit. Njëra nga referencat duhet të ofrohet nga ndonjë bankë e njohur nga BPK-ja apo firmë e auditimit që ka vërtetuar raportet e gjendjeve financiare/dëshmitë e burimeve financiare sipas pikës së lartpërmendur.

1.3 Përmbajtja e Planit të biznesit:

a. **Parashikimet financiare:** Plani i biznesit duhet të përmbajë parashikimin financiarë për pesë vitet e para të aktivitetit afarist të kompanisë. Aplikanti duhet të jetë i gatshëm dhe i aftë për t'i argumentuar të gjitha parashikimet e tij financiare, të cilat do të marrin formën e parashikimeve të bilancit të suksesit dhe të gjendjes.

Plani i biznesit duhet të ofroj parashikime financiare dhe kalkulime ekuivalente të aftësisë solvente sipas skemës në vijim:

1. Numri i policave që parashihen të shiten të jetë i njëjtë për pesë vite edhe primi mesatar për policë të sigurimit të jetë i njëjtë për secilin vit, ndërsa shpenzimet mesatare të dëmeve të rriten për 10% çdo vit.
2. Raporti i dëmeve të mundshme të jetë i krahasueshëm dhe konsistent me mesataret e industrisë së vendit për pesë vite.

Për këto parashikime do të shfrytëzohen format e parapara se si duhet të paraqiten në raporte. Parashikimet bazohen respektivisht kalkuloohen në këto forma:

1. llogaritja e primit të pafituar,
2. llogaritja e çmimit të shtyrë,
3. vlerësimi i investimeve,
4. numri i policave në vit ,
5. mesatarja e primeve të policave për vit,
6. mesatarja e shpenzimeve të dëmeve për dëmet e paguara,
7. normat e komisioneve të paguara për secilin vit për ndërmjetësit e sigurimit,
8. fitimi mesatar nga investimet.

b. Parashikimet e shkallës minimale të aftësisë paguese

Aplikanti është i obliguar në plan të biznesit të bëjë llogaritjen reale të shkallës minimale të aftësisë paguese të kompanisë për pesë vitet e para të veprimtarisë. Formula për llogaritjen e shkallës minimale të aftësisë paguese është e përshkruar në një rregull tjetër.

c. Shpërndarja: Metoda e propozuar e shpërndarjes për secilën kategori të biznesit të sigurimit, d.m.th shitja direkte, përmes bankës apo ndonjë institucion tjetër financiar, agjentëve apo ndërmjetësve.

d. Programi i risigurimit: Prezantimi i programit për risigurim të kompanisë së propozuar të sigurimit. Prezantimi duhet t'i trajtojë çështje si 1) ruajtja e niveleve neto të propozuara; 2) hollësitë rreth partnerëve risigurues të kompanisë dhe 3) lloji i programit të risigurimit të propozuar (d.m.th. teprica e humbjeve, proporcionaliteti).

e. Plani i marketingut: Plani i marketingut identifikon klientët e ardhshëm të kompanisë së propozuar të sigurimit. Kjo do të mund të përfshinte segmentimin e tregut sipas statistikave demografike (nivelet e të hyrave, gjininë, moshën, profesionin etj.).

f. Provizionet/komisionet: Informacionet sa u përket provizioneve/komisioneve që kompania e propozuar e sigurimeve planifikon t'ua paguajë ndërmjetësve të sigurimit. Kompanitë e sigurimit, të cilat zbulohen se ofrojnë përqindje më të madhe se provizionet/komisionet e cekura në planin e biznesit, do t'u nënshtrohen sanksioneve që parashohin rregulloret e BPK-së. Kompania e sigurimit në procedurë të licencimit duhet të sqarojë sesi do të sigurohet që ndërmjetësuesit e saj janë financiarisht të shëndoshë, me reputacion të mirë dhe besnikë në punën e tyre me klientët kosovar.

g. Firma e revizionit: Kompania e sigurimeve në procedurë të licencimit duhet të japë emrin dhe hollësitë tjera kontaktuese të firmës së licencuar për revizion. Firma e revizionit e paraqitur duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se ka përvojë të mjaftueshme në kontrollimin e kompanive të sigurimit dhe se i kupton plotësisht çështjet dhe sfidat në lidhje me revizionimin e veprimeve siguroese të kompanive kosovare të sigurimit.

h. Aktuari/eksperti i dëmeve: Përshkrimi i aktuarit apo ekspertit të rezervave për dëmet, duhet të përfshijë: (1) llogaritjen dhe përcaktimin e niveleve përkatëse të premive dhe (2) llogaritjen dhe përcaktimin e niveleve përkatëse të rezervave teknike, duke përfshirë rezervat për dëme si dhe rezervat për premitë e pafituara për kompaninë e sigurimit të përgjithshëm dhe për kompani të sigurimit të jetës; dhe, përshkrimi i vlerësimit të ekspertizës aktuariale, e cila shërben për qëllime të njëjta si për kompani të sigurimit të përgjithshëm ashtu edhe për kompanitë siguroese të jetës dhe

ka për qëllim krijimin e rezervave matematike dhe rezervave për devijime të ndryshme. BPK-ja pret që aktuarët si dhe ekspertët për llogaritjen e rezervave për dëmet e sigurimit të përgjithshëm dhe sigurimit të jetës të posedojnë kualifikime të njohura profesionale.

- i. **Aranzhimet bankare:** Aplikanti duhet ti paraqesë bankat të cilat i ka identifikuar për aranzhime bankare gjatë punës me kompaninë e sigurimeve. Aplikanti gjithashtu duhet të identifikojë dhe paraqesë se kush do të jetë i autorizuar për të nënshkruar transaksionet e mëdha të parave të gatshme brenda dhe jashtë llogarive bankare (prej 5000 euro dhe më shumë). Aksionarët, drejtorët dhe shefat ekzekutivë nuk do të autorizohen për të nënshkruar.

Llogaria operuese do të hapet në një bankë kosovare të aprovuar nga BPK-ja.

- j. **Politika e investimeve:** Aplikanti duhet të paraqes me një përmbledhje politikën e investimeve të kompanisë së sigurimeve, duhet të përshkruaj se si kompania e sigurimeve e sigurimit e propozuar për licencim do të dëshmojë se ka fonde të mjaftueshme për të paguar dëmet që duhen paguar.

- k. **Forma/modeli i policës, praktikës së dëmit, tarifave si dhe e premive.**

- l. **Kontrolli i brendshëm:** Mekanizmat e kontrollit të brendshëm si kërkesa për nënshkrime të dyfishta, vendimet e këshillit drejtues etj. që do të aplikohen gjatë veprimtarisë janë forma të politikave të kontrollit të brendshëm. Kopjet e dokumenteve të politikave, procedurave dhe praktikave të zhvilluara në këtë aspekt duhet të dorëzohen në BPK për miratim.

- m. **Teknologjia informative:** Përshkrim i sistemit kompjuterik dhe të telekomunikimit të cilin kompania e propozuar e sigurimit do ta përdorë.

- n. **Plani i rimëkëmbjes nga katastrofa:** Aplikanti duhet të dorëzojë një kopje të planit për rimëkëmbje nga katastrofa në BPK për miratim.

- o. **Personeli tjetër kryesor:** Personat e nominuar për rolin e nëpunësit juridik për pajtime si dhe revizori i brendshëm duhet të jenë gjithashtu të miratuar nga BPK-ja për funksionin e tyre.

1.4 Ndryshimet e mëdha në planin e biznesit:

Ndryshimet e mëdha në planin e biznesit të dorëzuara nga kompania e propozuar e sigurimit duhet të aprovohen nga BPK-ja. Një rregull tjetër e BPK-së përcakton çka konsideron BPK ndryshim të madh. Shkeljet e kësaj kërkesë

do t'u nënshtrohen sanksioneve të përshkruara në Rregulloren e sigurimeve të Kosovës si dhe në rregullat e BPK-së.

Neni 2

Kërkesat për ata/ato që dëshirojnë të punojnë nëpërmjet një kompanie të sigurimit të inkuorporuar në Kosovë

2.1 Kapitali minimal

Për licencimin e një kompanie të inkuorporuar të sigurimeve të përgjithshme në Kosovë kërkohet depozitimi i kapitalit themelues, në para të gatshme në BPK, në shumë jo më pak se tre milion euro (3'000'000.€).

Për themelimin e një kompanie të sigurimeve të jetës në Kosovë kërkohet depozitimi i kapitalit themelues në para të gatshme në BPK, për jo më pak se dy milion e pesëqind-mijë euro (2'500'000 €).

2.2 Aplikantët të licencuar jashtë Kosovës që dëshirojnë të licencojnë kompani subsidiare të sigurimeve në Kosovë

Për aplikantët e inkuorporuar jashtë Kosovës që dëshirojnë të hapin veprimtari subsidiare të sigurimeve në Kosovë, përveç kushteve për kapitalin minimal te paguar në pajtim me nenin 2.1, BPK-ja do të kërkojë:

Deklaratën e mbikëqyrësit në juridiksionin e vendit

Me të cilën shprehet pajtimi i autoritetit mbikëqyrës më qëllimin e aplikantit për të licencuar kompani subsidiare të sigurimit në Kosovë. Letra duhet të vërtetoj se aplikanti vepron në pajtim me ligjet e sigurimeve të vendit të tij, duke përfshirë informacionet tjera mbi aksionarët, kapitalin, aftësinë financiare të kompanisë mëmë, etj.

Raportet Financiare

Aplikantët jashtë Kosovës që dëshirojnë të inkuorporojnë një kompani subsidiare të sigurimit në Kosovë duhet të dorëzojnë raportet vjetore financiare të audituara për pesë vitet e fundit në gjuhën shqipe dhe/apo serbe apo angleze (përkthimi i dëshmuar në gjuhën angleze pranohet).

Nga aplikanti pritet që gjatë periudhës së mëparshme pesëvjeçare të ketë realizuar fitim së paku katër vjet.

Firma e auditimit

Firma e auditimit e licencuar dhe e propozuar për kompaninë subsidiare të sigurimit duhet të aprovohet nga BPK-ja.

2.3 Kushtet për ata/ato që dëshirojnë të licencohen si degë në Kosovë

Kompania e sigurimit e licencuar nën juridiksionin e huaj e cila dëshiron të licencoj degë të sigurimit në Kosovë, duhet të përmbush kushtet e parapara me nenin 2.1 (kapitali minimal) të kësaj rregulle. Gjysma e kapitalit do të depozitohet në para të gatshme (kesh) në BPK; gjysma tjetër e kapitalit minimal duhet të alokohet në bilancin e gjendjes së kompanisë mëmë. Alokimi nevojitet për të mbuluar rrezikun e degës dhe duhet të konfirmohet nga auditori i jashtëm.

Autoriteti vendor i mbikëqyrjes do të njoftohet nga ana e BPK-së për një alokim të tillë.

Deklarata e mbikëqyrësit në juridiksionin e vendit

Me të cilën shprehet pajtimi i autoritetit mbikëqyrës të vendit me qëllimin e aplikantit për të themeluar degë të sigurimit në Kosovë. Ky dokument, përveç tjerash, duhet të konfirmoj se aplikanti punon në pajtim me ligjet e vendit të tij, duke përfshirë informacionet mbi aksionarët, kapitalin, aftësinë financiare të kompanisë mëmë, etj.

Raportet financiare

Aplikanti jashtë Kosovës që dëshiron të licencoj një degë të kompanisë për sigurime në Kosovë, duhet të dorëzoj pasqyrat financiare vjetore të audituara për pesë vitet e fundit në shqip dhe/apo serbisht apo anglisht (përkthimi i dëshmuar në gjuhën angleze pranohet). Pritet që aplikanti të ketë realizuar fitim së paku katër vjet gjatë pesë viteve të fundit.

Firma e auditimit

Firma e licencuar e auditimit për degë të kompanive të sigurimeve duhet të aprovohet nga BPK-ja.

Mirëmbajtja e raporteve të konsoliduara financiare

Kompania mëmë duhet të mirëmbaj pasqyrat financiare të konsoliduara, ku duhet të pasqyrohen edhe aktivitetet e degës së saj që operon në Kosovë.

Neni 3

Revokimi i licencës së kompanisë së sigurimit

Kompania e sigurimeve e licencuar nga BPK-ja, është e obliguar ta ushtroj aktivitetin e vetë konform kushteve dhe rregullave të përshkruara në këtë rregull. BPK-ja ka të drejtë ta revokoj licencën e kompanisë së sigurimeve menjëherë, nëse konstaton se

kompania e sigurimeve e licencuar, ka ndryshuar cilindo faktor apo kusht të përshkruar në këtë rregull, pa lejen e saj për të ushtruar aktivitetin e vetë.

Licenca mund të revokohet edhe në rastin kur kompania e licencuar e sigurimeve nuk e ushtron aktivitetin e vetë konform Rregullores së sigurimeve të Kosovës dhe rregullave tjera të miratuara nga BPK-ja. Licenca mund të revokohet edhe në rastet kur kompania e sigurimeve me ushtrimin e aktivitetit të vetë bën shkelje të rregulloreve të miratuara nga çdo organ qeveritar në Kosovë.

Nëse një kompani e sigurimit nuk i fillon punët brenda gjashtë muajsh pas marrjes së licencës, BPK-ja automatikisht do të revokojë licencën e saj.

Neni 4 Dispozitat kalimtare

4.1 Kompanitë e licencuara të sigurimeve në Kosovë obligohen që ti përmbushin kërkesat shtesë të kapitalit sipas nenit 2.1 (kapitali minimal) dhe 2.2, të ndryshuar të kësaj rregulle, në afatet si vijon:

- 2.7 mil. Euro deri më 31 dhjetor 2005;
- 2.8 mil. Euro deri më 30 qershor 2006; dhe
- 3.0 mil. Euro deri më 31 dhjetor 2006

4.2 Degët e kompanive të sigurimeve duhet të depozitohen kapitalin në para të gatshme (kesh) në BPK, sipas nenit 2.3 të ndryshuar të kësaj rregulle, në afatet si vijon:

- 1 mil. Euro deri më 31 dhjetor 2005;
- 1,25 mil. Euro deri më 30 qershor 2006; dhe
- 1,5 mil. Euro deri më 31 dhjetor 2006

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i BPK-së.

Michel Svecine
Drejtore i Përgjithshëm